

Të nderuar kandidat,

Duke i marrë për bazë rrethanat e krijuara lidhur me Pandeminë COVID- 19, kemi hartuar një formë të re të aplikimit të kandidatëve për paraqitjen e provimeve për përtritje të licencave për shofer instruktor, ligjërues profesional si dhe seminarit për ligjërues profesional në ASH.

Për arsye të evitimit të grumbullimit të njerëzve dhe kontakteve, fillimisht do të i'u ipet përparësi kandidatëve që aplikojnë për **përtritje të licencave (rilicencim)**.

Kandidatët për shoferë-instruktorë dhe ligjerues profesional, të cilët **nuk kanë aplikuar deri tani për përtëritje të licencës**, aplikimin mund ta bëjnë përmes e-mailit, duke bashkangjitur dokumentacionin e nevojshëm në e-mail adresat sevdije.korqa@rks-gov.net, si dhe në numrin e telefonit **038-200-28-586**, për informacion. Sa i përket fletëpagesave, do t'ju njoftojmë individualisht me e-mail ose telefon, për mënyrën e pranim - dorëzimit.

Datat e aplikimit (paraqitjes së provimeve) për shofer instruktor, ligjërues profesional dhe seminarit për ligjerues profesional në ASH:

Paraqitja e provimeve për përtëritje të Licencës për **shofer instruktor**, do të bëhet deri më **21.08.2020**. Të gjithë kandidatët e interesuar dokumentacionin e kërkuar duhet ta dorëzojnë në pdf file. Dokumentacioni i dorëzuar në file jpg. ipg. etj. Ka mundësi të mos hapet dhe do të konsiderohet si dokumentacion i pakompletuar.

Paraqitja e provimeve për përtritje të Licencës për **Ligjerues Profesional në ASH**, do të bëhet deri më **21.08.2020**. Të gjithë kandidatët e interesuar dokumentacionin e kërkuar duhet ta dorëzojnë në pdf file. Dokumentacioni i dorëzuar në file jpg. ipg. etj. Ka mundësi të mos hapet dhe do të konsiderohet si dokumentacion i pakompletuar.

Kandidatët të cilët janë të obliguar të ndjekin seminarin. Paraqitjen për seminar për ligjerues profesional në ASH, mund ta bëjnë deri më **14.08.2020**.

Në bazë të numrit dhe datave të aplikimit do të formohen listat (grupet), gjithmonë duke ju përmbajtur rregullave të IKSHP-së, dhe do të njoftoheni për datat e provimeve.

Sa i përket seminarit për ligjerues profesional, do të i'u dërgohet materiali përmes postës elektronike me prezantime në power point. Për çdo pyetje apo paqartësi që mund të keni rreth materialit i cili do të ju dërgohet përmes emailit, mund të drejtoheni në e-mail adresën jakup.hoti@rks-gov.net dhe do të pranoni përgjigje.

Ju falemnderit për mirëkuptim!